



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr.182/2021

Datë: 10/06/2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me qëllim të përpjekjeve të institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara në Udhërrëfyesin për lëvizje të lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës në zonën Schengen të Bashkimit Evropian, pas ndryshimeve në Kodin Penal për veprën penale, Nxitja e përçarjes dhe mos durimit nga neni 141, dhe me qëllim të harmonizimit të praktikave me rastin e kualifikimit juridik të kësaj vepre nxjerrë këtë:

UDHËZIM

Për harmonizim të praktikave për kualifikim juridik të veprës penale Nxitja e përçarjes dhe mos durimit

Vepra penale Nxitja e përçarjes dhe mos durimit nga neni 141, që ka të bëjë me nxitje ose përhapje publikisht të urrejtjes, përçarjes dhe mos durimit midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat personale, duhet të trajtohen me efikasitet ngase është me interes të veçantë aplikimi i nenit 141 të Kodit të ri Penal (kjo vepër ka qenë e normuar me nenin 147 të Kodit të vjetër Penal).

Me qëllim të harmonizimit të praktikave me rastin e kualifikimit juridik të kësaj vepre penale, me qenë se forma themelore e kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiderohet se kryhet kur ndokush publikisht nxitë ose përhapë urrejtje, përçarje ose mos tolerancë kombëtare, racore, fetare ose etnike konsiderohet se kjo vepër kryhet nëse personi ndërmerren ndonjëherë nga këto veprime, e jo vetëm për faktin se njëra nga palët është e përkatësisë etnike tjetër pa u përmbushur njëri nga kushtet e lartpërmendura të këtij neni.

Me qëllim të përputhjes së statistikave të sakta ndërmjet Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë me rastin e regjistrimit dhe kategorizimit të këtyre rasteve, prokurorët kanë për obligim që në secilin rast kur përmendët neni 141, të marrin të gjitha veprimet për një cilësim adekuat dhe të saktë të veprës penale.

Kjo vepër penale është përfshirë edhe në veprat penale karakteristike në mekanizmin përcjellës, andaj, ky udhëzim duhet të zbatohet me përpikëri.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Ky udhëzim e shfuqizon udhëzimin e mëparshëm të datës 07 gusht 2015 me numër 781/2015.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për prokurorë.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksandër Lumezi



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse dhe të gjithë prokurorëve të shtetit.
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.